

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 399 Prot.Tiranë, më 11.06 2015

VENDIM Nr. 57 datë 04.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Durrësi në Antikitetin e Vonë"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues i tij Dr. Brikena Shkodra Rrugia,


VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Durrësi në Antikitetin e Vonë"* (bashkëlidhur planvendosja e zonës ku do të kryhet sondazhi), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues i tij Dr. Brikena Shkodra Rrugia, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Gërmime-sondazhi në hapsirën e lirë (200m²) pranë godinës së Albtelekomit në Durrës, ku ruhen mbetje të fortifikimit dhe kanalizimit të Durrësit.
- II. Periudha kohore e kryerjes së sondazhit do të jetë brenda vitit 2015.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO



Projekti Dyrachium ne Antikitetin e Vone: Vendndodhja e sondazhit te v.2015

Birkena Shkodro-Rrugie
[Signature]